



Nr. 1838 Prot.

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
INSTITUTIT TË KRIMEVE TË KRYERA GJATË LUFTËS NË KOSOVË
DHE
UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL), i përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Atdhe Hetemi dhe Universiteti i Tiranës, i përfaqësuar nga Rektori, z. Artan Hoxha, në vijim të referuar së bashku si "Palët".

Duke marrë parasysh mandatin ligjor dhe institucional të Institutit të Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë për dokumentimin, hulumtimin dhe analizimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare;

Duke marrë parasysh misionin dhe rolin e Universitetit të Tiranës në zhvillimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe avancimin e bashkëpunimit akademik në nivel rajonal dhe ndërkombëtar;

Duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërdisiplinor në studimin e krimeve të luftës, traumës psikologjike, kujtesës kolektive dhe proceseve të drejtësisë tranzicionale;

Duke synuar zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore, aktiviteteve akademike dhe publikimeve shkencore që kontribuojnë në ruajtjen e së vërtetës historike dhe avancimin e dijes shkencore;

Palët bien dakord për këtë Memorandum Bashkëpunimi si vijon:

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është vendosja e një kornize bashkëpunimi ndërinstitutional, akademik dhe shkencor ndërmjet Palëve në fushat e kërkimit, edukimit dhe zhvillimit profesional.
2. Përmes këtij Memorandumi synohet forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional për studimin, dokumentimin dhe analizimin shkencor të krimeve të luftës dhe pasojave të tyre shoqërore, juridike dhe psikologjike.

Neni 2

Objektivat e Bashkëpunimit

Objektivat kryesore të bashkëpunimit ndërmjet Palëve janë:

- Dokumentimi, sistemimi dhe analizimi i burimeve arkivore, dëshmime dhe materialeve historike që lidhen me krimet e luftës;
- Avancimi i studimeve akademike në fushat e drejtësisë tranzicionale, të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe studimeve të konfliktit;
- Promovimi i debatit shkencor dhe akademik mbi krimet e luftës dhe proceset e ballafaqimit me të kaluarën;
- Ruajtja dhe promovimi i kujtesës historike dhe shkencore përmes studimeve dhe publikimeve;
- Përfshirja e studentëve, studiuesve dhe stafit akademik në projekte kërkimore dhe aktivitete profesionale.

Neni 3

Fushat dhe Format e Bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të realizohet në këto forma:

- Realizimi i projekteve të përbashkëta kërkimore dhe studimore;
- Organizimi i konferencave shkencore, simpoziumeve, seminareve akademike dhe tryezave të rrumbullakëta;
- Shkëmbimi dhe përdorimi i literaturës shkencore, arkivave, databazave dhe dokumentacionit relevant për qëllime akademike dhe kërkimore;
- Botimi i monografive, studimeve, raporteve kërkimore dhe publikimeve të tjera shkencore të përbashkëta;

- Angazhimi i stafit akademik, studiuesve dhe ekspertëve të Palëve në projekte kërkimore, publikime dhe aktivitete akademike;
- Organizimi i ligjëratave, trajnimeve, seminareve dhe aktiviteteve edukative për studentët dhe studiuesit;
- Përfshirja e studentëve në praktika profesionale, projekte kërkimore dhe aktivitete akademike në bashkëpunim me Institutin;
- Aplikimi i përbashkët në projekte dhe fonde kërkimore vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 4 Koordinimi dhe Zbatimi

1. Për zbatimin e këtij Memorandumi, Palët angazhohen që të veprojnë me seriozitet dhe përkushtim.
2. Palët mund të krijojnë grupe të përbashkëta pune, komisione ose ekipe kërkimore për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve specifike.
3. Komunikimi ndërmjet palëve do të realizohet në formë shkresore dhe/ose elektronike, përmes kanaleve zyrtare të komunikimit të përcaktuar nga secila Palë. Informacioni që do të shkëmbehet në kuadër të kësaj marrëveshje duhet të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar.
4. Zbatimi i këtij Memorandumi nuk krijon obligime financiare për Palët, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshje të veçanta.

Neni 5 Kohëzgjatja

Ky Memorandum është i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar. Secila Palë mund të tërhiqet nga marrëveshja duke informuar Palën tjetër, me një njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.

Neni 6 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind gjatë interpretimit të kësaj marrëveshje do të zgjidhet nga Palët përmes bisedimeve pa nevojën për ndërmjetësim apo angazhime gjyqësore.

Neni 7 Hartimi i Memorandumit

Memorandumi është hartuar në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga udhëheqësit e institucioneve përkatëse në dy kopje identike.

Neni 8
Statusi ligjor

Ky Memorandum nuk paraqet një marrëveshje ndërkombëtare dhe nuk krijon detyrime që rrjedhin nga ligji ndërkombëtar.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Memorandumi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palët.

Palët nënshkruese

Prof. Ass. Dr. Atdhe Hetemi

Drejtor Ekzekutiv i IKKL-së

Datë: 23 / 05.2026



Prof. Dr. Artan Hoxha

Rektor i Universitetit të Tiranës

Datë: 28 / 05.2026

